



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVSTVA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org.Jednica Org Unit	01
Nr.Prut: Broj Prot: Prot.No	05-3035
Nr i faqeve Br.stranica No. pages	-7-
Data: Datum: Date	21/06/2022
Prishtinë / g	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Nr. 62/VI/2022
Datë: 21.06.2022

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të Nenit 145 (pika 2) e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7, 01 Mars 2019), bazuar në Nenin 8 të Rregullores Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, bazuar në Nenin 9 paragrafi 1.13 dhe nenin 89 të Ligjit nr.04/L-125 për shëndetësi, në zbatim të Ligjit nr. 07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, në zbatim të Vendimit Nr. 01/11 të datës 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës së shëndetit publik, në zbatim të pikës 52 të Vendimit Nr. 19/73 datë: 30.04.2022, nxjerrë:

V E N D I M

1. Aprovohen Udhëzuesit e përkohshëm dhe të veçantë për parandalimin dhe luftimin e COVID-19, me titujt si në vijim:
 - 1.1 Udhëzues i Përkohshëm për aplikimin e masave të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e COVID-19;
 - 1.2 Udhëzues i Përkohshëm për sektorin e shërbimeve personale dhe bizneseve, industrisë, administratës publike dhe OJQ-ve;
 - 1.3 Udhëzues i Përkohshëm për institucionet arsimore të të gjitha niveleve;
 - 1.4 Udhëzues i Përkohshëm për gastronomi, hoteleri, sektorin e shitjes dhe qendra tregtare;
 - 1.5 Udhëzues i Përkohshëm për tubimet fetare, varrime, punëtori dhe aktivitete kulturore;
 - 1.6 Udhëzues i Përkohshëm për fitnese, palestra dhe aktivitete tjera rekreative dhe sportive;
 - 1.7 Udhëzues i Përkohshëm për transportin publik dhe ndërkombëtar;
 - 1.8 Udhëzues i Përkohshëm për institucionet e kujdesit shëndetësor;
 - 1.9 Udhëzues i Përkohshëm për aviacionin civil;
 - 1.10 Udhëzues i Përkohshëm për institucionet korrektuese, qendra të azilit dhe të mbajtjes për të huaj;
2. Obligohen të gjitha institucionet relevante të zbatojnë në përpikmëri këta Udhëzues;

3. Në Shtojcën 1 të këtij Vendimi janë Udhëzuesit relevant të cilët janë pjesë e këtij Vendimi;
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.



Dr. Rifat Latifi

Ministër i Shëndetësisë

Vendim i dërgohet:

- Zëvendësministrave;
- IKSHPK;
- Anëtarëve;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamenti ligjor;
- Arkivit të MSh.

SHTOJCA 1. Udhëzuesit e përkohshëm dhe të veçantë për parandalimin dhe luftimin e COVID-19



*Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health*

**UDHËZUES I PËRKOHSHËM
APLIKIMI I MASAVE TË PËRGJITHSHME DHE TË
VEÇANTA PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E COVID-
19 NË AVIACIONIN CIVIL**

Prishtinë, 30 Prill 2022

Verzioni 1.14

Përmbajtja

Udhëzime specifike të parandalimit të përhapjes së COVID -19	3
Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC)	3
Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës 'Adem Jashari'	3
Agjensia e Shërbimeve të Navigimit Ajror – ASHNA	4
Federata Aeronautike Kosovës	4
Referencat	5

Udhëzime specifike të parandalimit të përhapjes së COVID -19

Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC)

- Mbajtja e pajisjeve personale mbrojtëse në objektin e AAC-së është e obligueshme.
- Dezinfektimi i objektit të AAC-së do të bëhet në intervale të caktuara kohore, sipas planit të hartuar paraprakisht.
- Kufizimi i kontaktit me palët e treta dhe shmangja/kufizimi i takimeve në grupe më të mëdha në kuadër të AAC-së.

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës 'Adem Jashari'

- Menaxhon rrjedhën e udhëtarëve para hyrjes në terminal, gjatë gjithë kohës së qëndrimit në aeroport, para nisjes në destinacionin e udhëtimit dhe gjatë mbërritjes nga aeroporti/porta ajrore e jashtme.
- Informon udhëtarët para mbërritjes në aeroport për rregullat/kushtet e nisjes në kontekst të situatës së krijuar me COVID-19.
- Rekomandohet bartja e maskës duke mbuluar hundën dhe gojën në ambientet e mbyllura.
- Lehtëson procedurat para nisjes dhe gjatë mbërritjes, duke zvogëluar sa më pak kontaktin fizik ndërmjet udhëtarëve dhe punonjësve ofrues të shërbimeve në terminal si dhe kohën e qëndrimit në hapësirat e terminalit.
- Siguron distancën fizike prej 1m ndërmjet udhëtarëve gjatë gjithë kohës së qëndrimit në terminal në nisje/mbërritje.
- Vendos shenjëzim në hapësira lidhur me mbajtjen e distances.
- Siguron pastrimin e shpeshtë të sipërfaqeve të kontaktit fizik gjatë kalimit të udhëtarëve nëpër terminal (karrocave të bagazhit, mbajtësve të shkallëve etj) dhe ajrosjen e shpeshtë të të gjitha hapësirave të mbyllura përmes ventilimit.
- Siguron sasi të mjaftueshme të pajisjeve personale mbrojtëse (PPM) për të gjithë punëtorët e aeroportit që ofrojnë shërbime në aeroport.

Agjensia e Shërbimeve të Navigimit Ajror - ASHNA

- Në hyrje të objektit duhet të vendosen shenjat e dukshme të rregullave të sjelljes për mbrojtje nga COVID 19 respektimin e distancës prej një (1) metër dhe shenja promovuese për vaksinim sipas dizajnit të Ministrisë së Shëndetësisë.
- Vendosja e dezinfektuesve për duar dhe maskave në hyrje të objektit dhe hapësirat e brendshme në vende të dukshme.
- Rekomandohet bartja e maskës duke mbuluar hundën dhe gojën në ambientet e mbyllura.
- Vendosja e dezinfektuesve për duar dhe alkoolit 60-70% në veturat që përdoren për punë në terren.
- Vendosja e dezinfektuesve për duar dhe alkoolit 60-70% për dezinfektim të paisjeve të punës në vendet ku ndodhen paisjet e Navigimit, Survejimit, Mikroprocesimit, Com-Met-it, Klimatizimit dhe Tensionit të lartë.
- Vendosja e alkoolit 60-70 % për dezinfektimin e mjeteve të punës (për stafin me veprim operativ) dhe të tjerët.
- Pastrimi i vazhdueshëm dhe ajrosja e ambientit të punës.
- Dezinfektimi i rregullt i të gjitha hapësirave të punës pas çdo rasti Covid pozitiv dhe të dyshuar.
- Dezinfektimi i vazhdueshëm i veturave që përdoren për punë në terren.

Federata Aeronautike Kosovës

- Meqenëse ka të bëjë me një aktivitet rekreativo-sportiv individual që kryhet në ambient të hapur (fluturime me paraglajd) dhe pa ndërveprim fizik ndërmjet pjesëmarrësve gjatë zhvillimit të tij, Federata duhet të sigurohet që në fazat parapërgatitore të aktiviteteve të veta të marrë masa që pjesëmarrësit në gara/ushtrime me paraglajd të udhëtojnë në grupe të vogla, deri në katër pjesëtarë, duke zbatuar masat mbrojtëse.

Vërejtje: Verifikimi i zbatimit të këtyre masave bëhet në vazhdimësi dhe kryhet në intervale të ndryshme kohore nga AAC-ja si organ mbikëzrës dhe rregullator, përmes inspektimeve të rregullta apo ad-hoc në terren që kryhen nga inspektorët e AACK!

Referencat

1. COVID-19 Guidance: Businesses and Employers | CDC
<https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/community/guidance-business-response.html>
2. COVID-19 Guidance: Employers, Workplaces & Businesses – City of Toronto
<https://www.toronto.ca/home/COVID-19/COVID-19-reopening-recovery-rebuild/COVID-19-reopening-guidelines-for-businesses-organizations/COVID-19-guidance-employers-workplaces-businesses/>
3. Advice for the public | WHO
<https://www.who.int/emergencies/diseases/novel-coronavirus-2019/advice-for-public>
4. COVID-19: Infection prevention and control (IPC) - GOV.UK
<https://www.gov.uk/government/publications/wuhan-novel-coronavirus-infection-prevention-and-control>
5. WHO/Europe | Coronavirus disease (COVID-19) outbreak - Interim Guidance for COVID-19 prevention and control in schools, March 2020
<https://www.euro.who.int/en/health-topics/health-emergencies/coronavirus-COVID-19/publications-and-technical-guidance/2020/interim-guidance-for-COVID-19-prevention-and-control-in-schools,-march-2020>
6. Pregnant women being infected at higher rates; COVID-19 from UK variant lasting longer
<https://www.reuters.com/article/us-health-coronavirus-science-idINKBN2AM2GQ>
7. Passenger Health Safety – updated measures for summer 2020 | EASA (europa.eu)
8. Urdhëresa administrative e AACK nr 03/2020 mbi Përgatitjet e aeroporteve për kthim në operime normale, rreth ofrimit të shërbimeve në tokë në aeroporte dhe zbatimin e protokollit të sigurisë së shëndetit në aviacion për COVID-19
9. Qarkorja Informative për mbrojtjen nga COVID-19 për personelin e AACK-së;
10. Plani i Veprimit të ANP ‘Adem Jashari’ për rifillimin e operimeve që është paraqitur para AACK.